Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;

c. Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;

e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;

f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;

g. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;

gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të

kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 12 te ketyre DT (**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit**) pikat,1;2;3

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- Xhiroja mesatare vjetore per tre vitet e fundit (**2016,2017,2018**) duhet të ketë një vlerë sa te pakten **50% e fondit limit qe prokurohet.**
- Kopje të vërtetuar të bilanceve per vitin **2017 dhe 2018**, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse dhe i konfirmuar.
- Vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2019 prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin.*(Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2019 per secilin operator)*

2.3 Per kapacitetin teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) Punëtëngjashmepërnjëobjektëvetëm me vlerë 50% e vlerësëpërllogariturtëkontratësqëprokurohet.

b) Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej 2 kushteve te siperpermendura e ben Oferten te kualifikueshme.

Per te vertetuar përvojën e suksesshme në ekzekutimin e puneve te ngjashme, Operatori Ekonomik duhet te paraqese dokumentat e meposhtem :

a) Per objektet e financuara me fonde publike:

- Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9
- Kontratën e Sipërmarrjes;
- Situacionin përfundimtar të objektit;
- Akt kolaudimi përfundimtar objekti;
- Aktin e marrjes ne dorëzimit të objektit.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës 9
- Kontratën e Sipërmarrjes,
- Situacion përfundimtar të objektit,
- Aktin e Kolaudimi përfundimtar të objektit,
- Aktin e marrjes ne dorëzimit të objektit,
- Faturat Tatimore.

2.3/1 Licensa profesionale te shoqerise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës :

- Punime germimi ne toke **N.P.1, -Klasifikim ‘A’.**
- Ujesjellësa, gazsjellësa etj **N.P.7, -Klasifikim ‘A’.**

- Punime te inxhinierise se mjedisit **N.P. 12 , - Klasifikim “A”**
- Impiante hidro-sanitare etj **N.S.2, -Klasifikim ‘A’.**
- Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to etj. **N.S.4, -Klasifikim ‘A’.**
- Ndertime parafabrikat beton arme ,struktura metalike dhe druri **N.S.8,- Klasifikim “A”**
- Punime Topogjeodezike **N.S.18, -Klasifikim ‘A’.**

2.3/2 Shoqeria duhet te ketene stafin e tij drejtues (ne licensen e shoqerise):

- Inxhinier ndertimi 1(nje)
 - Inxhinier hidroteknik 1(nje)
 - Inxhinier gjeodet 1(nje)
 - Inxhinier Mjedisi 1(nje)
 - Inxhinier Mekanik 1(nje)
 - Inxhinier Gjeolog 1(nje)
- *Te gjithë punonjesit e kerkuar sipas pikes 2.3/2, te jene te shoqeruar me diplome, kontrata pune,CV e librezë pune.*
- *Stafi drejtues i shoqerise (ing.ndertimi, ing.hidroteknik dhe ing. gjeodet, ing. gjeolog, ing.mjedisi, ing.mekanik) duhet te jene drejtues teknike ne licensen e shoqerise si dhe ne listepagesat per periudhen Janar 2020–Maj2020.*
- *Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate nga administratori i shoqerise pjesemarrrese ne kete prokurim, qe stafi i inxhinierëve, te kerkuar me siper, jane te disponueshem per realizimin e kesaj kontrate dhe nuk jane te angazhuar ne kontrata te tjera.*

2.3/3Operatori ekonomik duhet te ketene staf ose me kontratebashkepunimi te vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates si me poshte :

Inxhinier ndertimi civil ,ekspert te strukturave dhe analizimitte tyre me ane te prove jo shkaterruese ne strukture. Inxhinieri civil duhet te jete i pajisur me diplomën perkatese, si dhe me Certificate e Nivelitte II, N 23872/ PND/C ,si dhe te disponoje pajisjet per realizimin e provave joshkaterruese ne strukture. Pajisjet :

1 (nje) Endoskopsecur/scan MW60vvzt

1 (nje) KamerTermike AVIO TVS 500 EX GPR RIS

Ketopajisjeduhetteshoqerohen me faturetatimoreblerje.

2.3/4 Shoqeria duhet te kete ne stafin e saj specialiste ndertimi te certifikuar sipas profesioneve si me poshte:

- Teknike ndertimi 1 (nje)
- Teknik Mekanik 1 (nje)

- Hidraulik1 (nje)
- Saldator1 (nje)

Per specialistet e kerkuar me siper **(pika 2.3/4)**per teknik ndertimi dhe teknik.mekanik te paraqiten dokument per klualifimi profesio. *diplome/deftese*, e leshuar nga organet shteterore si dhe dokument per kualifikimintekniksi dhe Kontrata e punes te tyre.

Per specialistet Hidraulike dhe Saldator te paraqitet *nje deshmi kualifikimi ose certificate trajnimi te leshuara nga organet shteterore apo nga subjektet juridike private te akredituara per certifikimin e puninjeseve*.Per punonjesit e mesiperm duhet te paraqitet kontrata e punes e vleshme,deshmite e kualifikimit te sigurimit teknik,(te vlefshme),leshuar nga instucionet perkatese.
Specialistet e mesiperm duhet te figurojne ne listepagesen e shoqerise perJanar 2020–Maj 2020.

2.3/5Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar nje mjek, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figuroje në listëpagesa per periudhen **Janar 2020–Maj 2020**

2.3/6Një punësim mesatar per periudhen Janar 2020–Maj 2020, i te pakten25 **personave** me kohe te plote pune, duke përfshirë stafin e përhershëm;

- *Kjo pike dokumentohet me vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike .*
- *Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)*

2.3/7Operatoriekonomikofertuesduhettëketëtëpunësuarminimalisht**2(dy)** **punonjësmanovratorëtëmjetevetërëndateciletnjëautomakinistedhenjëskaikatorist.** *Përkëtopunonjësduhettëparaqitetkontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (tëvlefshme), lëshuarngainstitucionetperkatësesidhetëfigurojnënëlistpagesat e shoqërisë perperiudhenJanar 2020–Maj 2020*

Manovratorët duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rëndadhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor.

2.3/8**Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës**

- Eskavatore me Zinxhire cope 1(nje)
- Minieskavator cope 1(nje)
- Eskavator me Goma cope 1(nje)
- Kamion veteshkarkues(kapacitet mbajtes nga 12 deri 18 ton) cope 1(nje),
- Kamion veteshkarkues(kapacitet mbajtes mbi 18 ton) cope 1(nje),
- Kamion vetshkarkues me vinç (kapacitet mbajtes nga 3.5 deri 5 ton) cope 1 (nje)
- Betoniere 3m3 cope 1(nje)
- Gjenerator cope 1(nje)
- Depozite uji (5000 litra) cope 1(nje)
- Vibrator betoni cope 1(nje)
- Matrapik cope 1 (nje)

Dokumenta Standarde të Tenderit

- Sharre Alsfalti Cope 1 (nje)
- Elektro betoniere 0.33 m3 Cope 2 (dy)

Makinerite dhe Pajisjet te jene ne pronesi ose me qira.

Per mjetet e transportit në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti (i vlefshëm), e)taksa vjetore e mjetit, f) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme)(te cilat duhet te jene ne emer te shoqerise) dhe fotot e mjeteve.

Per mjetet dhe pajisjet e tjera ne pronesi te cilat nuk kane leje qarkullimi ofertuesi duhet te paraqesëfatura tatimore te blerjes ose dokument zhdoganimi te mjeteve e paisjeve.

Pranohet marrja me qira ose huaperdorje e mjeteve te mesiperme, me kusht qe kontratat e qiramarrjes ose te huaperdorjes te jene te lidhura para noterit, me afat vlefshmerie brenda afatit te zbatimit te punimeve per kete objekt te shoqeruara me dokumentat e cilesuara me lart per mjetet e paisjet ne pronesi.

- Paisje per mbrojtjen ne pune.
 - Kokorecope 20 (njezete)
 - Tabelasinjalizuse cope 10 (dhjete)
 - Kutitendihmes e se shpejtecope 5(pese)

2.3/9 Shoqeria duhet te jete e pajisur edhe me çertifikatat e meposhtme:

- a)Operatori ekonomik pjesmarrësduhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 9001-2015 (e vlefshme)**(Nërastet e bashkimittëoperatorëveekonomik, çdoanëtar i grupitduhettëparaqesëÇertifikatën ISO).
- b) Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 45001-2018 (e vlefshme)**. (Nërastet e bashkimittëoperatorëveekonomik, çdoanëtar i grupitduhettëparaqesëÇertifikatën ISO).
- c)Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **OHSAS 18001-2007**(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS / ISO).
- d)Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë **ISO 39001 -2012 (e vlefshme)**.(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- e)Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **certifikatë [PAS-99;2012]** .(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO)

2.3/10 a) Per Operatorin ekonomik kërkohej që Inxhinieri i Mjedisit të jetë i pajisur me Certifikatat e Licensave të vijon;

1. Certifikate për hartimin e raporteve të vlerësimit të mjedisit në mjedis,

2. License Kategoria 5 C (Ujësjellës kanalizime urbane- rurale)

b) Operatori ekonomik ofertues duhet qënjë drejtues i teknikut përmbush kriterin për teqenë koordinator në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe që të disponojë shërbime të trajnimit të Specialistëve për sigurimin e teknikut dhe shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Përsigurimi i shëndetit në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Përmiratimin e erregullores “Përsigurimi në kantier”. Për specialistin e shoqërisë duhet të paraqitet **certifikata e trajnimit për Specialist për sigurimin e teknikut dhe shëndetit në punë**” e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikim i shqiptarose i huaj dhe kontrata e punës së duhet të jetë e përfshirë në listë pagesash e shoqërisë për të paktën 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit

2.3/10 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtnesin Teknik të punëve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë prezent gjatë gjithë kohës në objekt.

Bashkëlidhur deklaratës për Drejtnesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma, CV, librezë pune.

2.3/11 Operatori ekonomik ofertues (Administratori i shoqërisë ofertuese), duhet të paraqesë një deklaratë që makineritë e kërkuara në pikën **2.3.7**, nuk duhet të jenë të angazhuara në ndonjë kontratë/kontrata të tjera në fuqi, dhe nuk janë të deklaruar në procedurat e shpallura fitues nga Autoritetin Kontraktor Bashkia Patos, por vetëm për këtë objekt. Gjithashtu në deklaratë duhet të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi. Komisioni i vlerësimit të ofertës i lind e drejta për të verifikuar në kantier disponueshmërinë e makinerive të deklaruar.

2.3/12 Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licensës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimi” (Deklarate nga administratori i shoqërisë)

2.3/13 Grafiku i Punëve.

Shënim:

- Në rast se ofertë paraqitet nga bashkim operatori ekonomik, Shtojca nr.12 e DST (Kriteret e veçantave të kualifikimit) duhet të plotësohet në përputhje me nenin 74 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”
- **Autoriteti kontraktor rezervon të drejtat kryesive të gjithë verifikimet e nevojshme për të vertetuar deklarinë e mesipërm.**

Dokumenta Standarde të Tenderit

- Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen sikur shpesh për skualifikim.

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrim i punëve

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE


NR	Nr Analizes	EMERTIMI I PUNIMEVE	NUESIA	Sasia sipas kaneleve					SASIA TOTALE	CMIMI (leke)	VLERA (leke)
				U-1-1	U-1-1/1 Terciar	U-1-3 D	U-1-3 M	U-1-4			
1	3-2-3-7	Pretje hime e shkullje rrezeje Ft deri 10 cm	m2	1314.00	408.56	1287.00	1432.80	728.00	5171.36	48	248225
2	3-2-5/a +3-10/a+3-95/a +3-104/a+3-98/a	Gerrimi dheur për rreskolinjimin e kanalit (70% gerrimi me makineri nga e cilës 20% me shkakrim në mjel)	m3	882.91	379.41	365.03	403.61	468.45	2489.41	422	1054128
3	3-4-7 b	Mbushje e ngjeshje me erke për rreskolinjimin	m3	208.10	158.00	201.87	228.43	134.00	930.40	193	179567
4	3-158 Za	Transport dheur me auto deri në 2 km	m3	176.58	31.60	73.01	80.7		361.91	170	61525
5	3-239	Veshje e kanalit me beton M 100, f=5 cm (nenshtese)	m3	31.29	24.38	35.20	56.65	44.97	192.49	9326	1795165
6	3-243/1	Veshje e kanalit me blarë M 200, f=7 cm	m3	49.27	38.40	115.50	89.22	70.80	362.99	11237	4078989
7	3-243	Beton M 200 për riparim vepash ekz.	m3	3.80	0.00	8.40	5.20	2.80	19.80	11105	219879
8	3-288	Hekur beton i vaskuar për performim Ft 6 mm (në formë zgarë kuadratikë me dimensione 20x20cm)	ton	1.527	1.189	3.69	3.70	2.24	12.34	106741	1317614
9	An 1	Ndërtim ure auto h=0.8 m H=0.7m, L=5 m (analize për 1 cope)	cope			3.00			3.00	157384	472153
10	An 1/1	Ndërtim ure auto h=0.8 m H=0.7m, L=6 m (analize për 1 cope)	cope			1.00			1.00	189785	189785
11	An 2	Ndërtim ure kembesore Hd= 4 m , B= 1 m (analize për 1 cope)	cope	2.00	1.00		1.00		4.00	25711	102842
12	An 6	Kalim me tub çeliku Ft406/5.5 mm (tip bombino), PK 3-5a, në kanal të tjerë U1-1/1, (analize)			1.00				1.00	153925	153925
13	An 3	Ndërtim prizë 40x60 cm	cope					1.00	1.00	50892	50892
14	An 3/1	Ndërtim prizë 40x60 me barazh 40x60cm	cope	2.00		1.00			3.00	95201	285604
15	An 4	Ndërtim prizë për marrje uji , me nënkalin tub çeliku Ft 406/5.6 mm, L = 6 m (analize për 1 cope)	cope				2.00	2.00	4.00	9819	39278
16	An 4/1	Ndërtim prizë për marrje uji , me nënkalin tub çeliku Ft 406/5.6 mm, L = 7 m (analize për 1 cope)	cope			1.00			1.00	161166	161166
17	An 5	Ndërtim barazhi me portë metalike 40x60 cm (BxH)	cope		1.00	1.00			2.00	42358	84716
18	An 5/1	Ndërtim barazhi me portë metalike 60x60 cm (BxH)	cope			1.00			1.00	53056	53056
19	3-644	F. vendosje Porte metalike 60x60 cm . 2 cope	ton	1.00		1.00			0.196	143246	28076
20	3-644	F. vendosje Porte metalike 40x60 cm . 3 cope	ton	1.00		1.00			0.252		0
21	An 7	Pristje e shkullje vepa ari te demluara	cope	2.00		3.00	2.00	1.00	8.00	8256	66047
		Shuma									10,642,233
		Fond rezervë 5 %									532,112
		Shuma Ndërtim montim									11,174,345
		Shpenzime për mbikëqyrje e kalcitimit punimeve									367,636
		Shuma									11,541,981
		TVSH 20 %									2,308,366
		Shuma TOTALE									13,850,377

Shtëmtim:

Në këtë projekt të preventivës përshihet vazhdimi i rehabilitimit të rrjetit ujëtar të shkollës, duke përfshirë në këtë rast veprimet e ndërtimit të rrjetit ujëtar të shkollës, duke përfshirë në këtë rast veprimet e ndërtimit të rrjetit ujëtar të shkollës.

- vijon -

"Setas" Ltd.



Objekti: REHABILITIMI I UJËTARËS (RRJETIT SEKONDAR) NË FUSHËN E SHKOLLËS E GJUMBRASHI, SHYQYSHIK
PREVENTIVI PËRMBLEDHËS I PUNIMEVE

Shtojca14.

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
<Emri>

Shtojca 15

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |
| 2. _____ | _____ |

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ /Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. ____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]*, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv për njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në

Dokumenta Standarde të Tenderit

referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe

Dokumenta Standarde të Tenderit

shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupsuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsuara. Veprimet e korrupsuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të

Dokumenta Standarde të Tenderit

dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkepusojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në

Grafikun e realizimit te punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim te rastit kur keto te fundit, kishin gabime te dukshe qe mund te ishin konstatuar lehtesisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes se Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit.

Dokumenta Standarde të Tenderit

Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezyrtshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda

afatit të parashikuar në njoftim.

